



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 47

Datë: 13. 09. 2017, ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Eshref Vishi, anëtarë i KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyesë: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së: *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr 44/2017*

2. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për zëvendësimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës,

3. Të ndryshme

1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr 44/2017

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 47 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me rend dite si para jush. A ka dikush vërejtje në këtë rend dite? Urdhëro Bajram.

Bajram Ljatifi: Për shkak të opinioninit, por edhe për shkak t'onin, rekomandimi i shërbimit duhet të jetë: “Rekomandim i radhës për zëvendësimin e deputetit”, dhe jo “Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për zëvendësimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës”. Ne, nuk zëvendësojmë as nuk japim rekomandim për zëvendësim...

Valdete Daka: E pranojmë vërejtjen, po për herën e par jemi duke i zëvendësuar... Kush është për këtë rend dite.

Anëtarët e KQZ, miratuan rendin e ditës

Adnan Rustemi: Procesverbali duhet të hiqet sepse, nuk ka material...! E kemi vetëm një pikë të rendit të ditës...Kush është për këtë rend të ditës...?

Anëtarët e KQZ, miratuan rendin e ditës

2. Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për zëvendësimin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës,

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare. Në mbledhjen e Këshillit për Çështje Ligjore, e kemi shqyrtuar, realisht, në kuptimin e plotë verifikim nga zyra në renditjen e kandidatëve të cilët, do të zëvendësohen..., letrën që ka ardhur nga Presidenti për shqyrtimin dhe zëvendësimin e kandidatëve të radhës për shkak të marrjes së posteve ekzekutive nga ana e deputetëve. Nga ana e zyrës ligjore, është prezantuar dokumentacioni i plot që plotësohen gjitha konditat që të bëhen këto zëvendësime, dhe është dashur sugjerim që të vendoset në KQZ për zëvendësimin e këtyre....

Valdete Daka: Faleminderit, a ka nevojë mi lexuar emrat...? Nëse jo, atëherë sipas radhës: Nait Hasani, do ta zëvendësoj z. Ramush Haradinajn, Fadil Beka, e zëvendëson Fatmir Limajn, Enver Hoti, e zëvendëson Enver Hoxhaj, Gani Dreshajn e zëvendëson Rustem Berisha, Bekë Berisha e zëvendëson Pal Lekajn, Imet Rrahmani e zëvendëson Behgjet Pacollin, dhe Barim Shabani e zëvendëson Rasim Demirin, të gjithë këta nga subjektet përkatëse. Atëherë, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht këto rekomandime.

Valdete Daka: Menjëherë pas kësaj mbledhje, t'i dërgohet shkresa Presidentit të Republikës me emrat përkatës...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
